



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion.

Qendra Shqiptare MediaLook

E nderuar Znj. Haklaj

Referuar kërkesës për informacion, në lidhje me sigurinë e lodrave, drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut ju informojmë si më poshtë vijon:

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut organizohet si drejtori e përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendit. Gjatë viteve 2018-2023 nga ISHMT janë realizuar në total 323 inspektime në fushën e produkteve lodra, ku janë kontrolluar 4604 produkte nga të cilat janë konstatuar 305 produkte jo në konformitet dhe janë marrë 85 masa urgjente.

Referuar lodrave të evidentuara në tabelën e publikuar në faqen zyrtare të ISHMT, të cilat janë klasifikuar si produkte me rrezikshmëri, ju sqarojmë se këto produkte lodra janë identifikuar si rezultat i analizave laboratorike të kryera në laborator të akredituar jashtë vendit.

Shqipëria aktualisht nuk disponon një laborator të akredituar për të kryer analizat e produkteve në fjalë, për këtë arsye Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në rastet e dyshimeve mbi konformitetin e produkteve ka realizuar kontrollin laboratorik për 42 mostra lodra të cilat janë analizuar në laborator të akredituar në vendet e BE.

Nga analizat laboratorike kanë rezultuar:

- 11 Lodra në mospërputhshmëri me karakteristikat fizike/mekanike (EN 71-1) që shfaqin risk të mbytjes/gëlltitjes/prerjeve etj.
- 16 Lodra me risk kimik, për shkak të nivele të larta të estereve të ftalatit (DEHP, DBP, BBP, DINP, DIDP, DNOP) mbi nivelin e lejuar <0.1% në peshë të materialit plastic dhe klasifikuar si substanca me rrezikshmëri shumë të lartë SVHC I kategorisë 1B toksik për riprodhimin.
- 5 Lodra të kategorisë “Slime”, me risk kimik për shkak të nivel të lartë të migrimit të metaleve të rënda (Boronit), me rrezik dëmtimi të sistemit të riprodhimit.

Për këto produkte (rreth 10 mijë njësi) u morën masat për ndalimin e tregtimit/tërheqjen nga tregu dhe lajmërimin e konsumatorit për riskun e paraqitur. Informacioni mbi lodrat si foto/kod/barkod/numër artikulli/kategoria e riskut u publikua në faqen zyrtare të ISHMT për të informuar publikun e gjerë. Po kështu u realizuan disa dalje në media vizive për të rritur

ndërgjegjësimin e prindërve për kujdesin që duhet të tregojnë në përzgjedhjen e lodrave sa më të sigurta për fëmijët e tyre duke kontrolluar markimet përkatëse dhe paralajmërimet. Në kuadër të bashkëpunimit me DPD jemi në fazën e hartimit të një marrveshje e cila është në proces. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve/ISHMT ka vijuar kontrollin dhe ka dhënë kontributin e saj në vijim të kërkesave nga DPD për kontrollin formal dhe të dokumentave të produkteve joushqimore që kalojnë në pikat doganore. Nga ana e ISHMT-së është ofruar asistencë teknike për vlerësimin e dokumentacioneve dhe markimit CE, të cilat janë kritere të detyrueshme për vendosjen në treg sipas Ligjit Nr.10489/2011, kryesisht për produkte mekanike, elektrike dhe lodra të deklaruara për t'u vendosur për qarkullim të lirë.

Duke ju falenderuar,